

KOMPANIA KOSOVARE PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A.
KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY J.S.C.
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA SNABDEVANJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.O.O.KESCO SH.A.
Nr. 45 Dt. 28.12.2021
HQ 1**Ymer Fejzullahu**
Kryesues i Bordit të ZRrE-së**Mesut Serhat Dinc**
Drejtore i Përgjithshëm
KESCO sh.a**28 dhjetor 2021****Lënda: Aplikimi për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal**

I nderuar z. Fejzullahu,

Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU) ka përgatitur Aplikimin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale në përputhje me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së dhe Njoftimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për hapjen e procesit të Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm të datës 13 dhjetor 2021.

Duke pasur parasysh rendësin e këtij procesi, FSHU mbetet i përkushtuar për bashkëpunim me qëllim që të arrihet deri tek një zgjidhje e përbashkët për të gjitha palët pjesëmarrëse në sektorin e energjisë.

FSHU është i gatshëm që në çdo kohë të takohet me ZRRE-në për t'i diskutuar çështjet e ngritura në këtë aplikim.

Me respekt,


Mesut Serhat Dinc

Drejtore i Përgjithshëm, KESCO sh.a

***Aplikim për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të
të Hyrave të Lejuara Maksimale për
Furnizuesin me Shërbim Universal***



Ndërtesa e ElektroKosovës
Bulevardi Bill Clinton nr 3
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

Elektroenergeti Rastërre
Bill Clinton Bulevardi nr 3
Prishtinë 10 000
Republik of Kosovo

Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Ndikimi financiar i çmimeve të energjisë elektrike.....	4
3. Kërkesa për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2022	6

1. Hyrje

Kriza energjetike e cila ka përfshirë mbarë botën si pasojë e rritjes enorme të çmimeve të energjisë elektrike ka vështirësuar stabilitetin financiar të sektorit, e cila është duke u vështirësuar çdo ditë e më shumë.

Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU) qysh nga korriku i vitit 2021 ka vërejtur sinjalet globale të rritjes së çmimeve të energjisë. Duke parë se situata do të jetë serioze në muajt në vazhdim FSHU në gusht të vitit 2021 kishte drejtuar një letër informuese Ministrisë së Ekonomisë (ME) pak ditë para se Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) të publikojë Raportin Konsultativ për të Hyrat e FSHU-së për vitin 2021.

Në muajin gusht të këtij viti Zyra e Rregullatorit për Energji publikoj Raportin Konsultativ për të hyrat e të licencuarit për vitin 2021 i cili nuk mori për bazë asnjë nga të dhënat aktuale të paraqitura nga FSHU-ja. Pas reagimit të licencuarit, në shqyrtimin përfundimtar të të hyrave të lejuara maksimale për vitin 2021, ZRRE mori për bazë të dhënat aktuale janar-korrik, por injoroi kërkesat e FSHU-së për të reflektuar çmimet e pritshme të importit, sipas parashikimeve të tregjeve ndërkombëtare duke vendosur një çmim jorealit prej afro 60% më të ulët sesa çmimi i pritur, respektivisht i realizuar për muajt gusht-dhjetor 2021. Kështu me datë 07.10.2021 përmes vendimit V_1424_2021, ZRRE-ja aprovoi të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për Furnizuesin e Shërbimit Universal për vitin 2021 në vlerën prej 290,139,654 €. MAR-i i aprovuar për vitin 2021 pasqyroi shitjet dhe kostot aktuale për periudhën janar-korrik dhe shitjet dhe kostot e pritshme për periudhën gusht-dhjetor sipas bilancit energjetik të aprovuar për vitin 2021. Megjithatë MAR-i i aprovuar mori për bazë të dhënat aktuale janar-korrik, vetëm deri në tetor të vitit 2021, kostot për blerje të energjisë me shumicë arritën vlerën prej 123.7 milion € nga 117.3 milion € sa ishin lejuar.

Përveç rritjes së çmimeve në tregjet me shumicë, situata filloi të rëndohej edhe më tutje për shkak të një rritje enorme të konsumit të energjisë elektrike në Kosovë. Kjo rritje ka ndikuar në rritje të sasisë së energjisë e cila duhet të importuar me qëllim të mbulimit të konsumit dhe për nevojat e rrjetit. Duke qenë se prodhimi vendor nuk mund të plotësojë të gjithë kërkesën për energji elektrike, sasia e nevojshëm e importit tejkalon sasisë e lejuara nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimit të rregullt tarifor. Importi shtesë paraqet edhe kosto shtesë për FSHU-në, kosto të cilat nuk janë parashikuar në të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2021.

Në këtë kuptim, marrë parasysh çmimet në rritje të vazhdueshme të importit, FSHU-së i duhet të përballojë e vetme barrën financiare deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor, duke rrezikuar kështu pozitën e tij financiare. Prandaj, më 28 tetor 2021 FSHU-ja përdori të drejtën e dhënë përmes Rregullës për të Hyrat e FSHU-së dhe dorëzoi kërkesën për hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm, e cila u trajtuar nga Rregullatori vetëm në dhjetor të vitit 2021. Mos trajtimi i menjëhershëm i kërkesës së FSHU-së, e ngritur edhe përmes shkresave zyrtare, rrezikoi likuiditetin financiar, duke rritur obligimet e FSHU-së ndaj të licencuarve tjerë.

ZRRE, vetëm pas pranimit të kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm edhe nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes me datë 13 dhjetor 2021, ka hapur procesin për shqyrtim të jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST, OSSH dhe FSHU. Gjatë këtij procesi ZRRE-ja do të shqyrtojë aplikacionet e të licencuarve dhe do të analizojë të gjitha rrethanat e krijuara në sektorin e energjisë lidhur me kostot e sistemit si dhe menaxhimin e sigurisë së furnizimit.

Ne vlerësojmë procesin për hapje të shqyrtimit të jashtëzakonshëm dhe kërkojmë nga Rregullatori që të reflektoj drejtë kostot e pritshme me qëllim të ruajtjes së stabilitetit të furnizimit me energji elektrike.

2. Ndikimi financiar i çmimeve të energjisë elektrike

Gjatë shqyrtimi të të hyrave të lejuara maksimale, shitjet e vlerësuar për vitin 2021 ishin 4,503 GWh, përkatësisht kostoja e aprovuar për blerjet me shumicë me qëllim të mbulimit të këtyre shitjeve ishte 143.10 milion €. Të dhënat aktuale tregojnë se shitjet kanë shënuar rritje për 5% në volume, ndërsa kostoja financiare ka shënuar rritje për 12% krahasuar me ato të lejuara, megjithëse të njëjtat kishin marrë për bazë të dhënat aktuale për muajt janar-korrik.

Blerjet në MWh	Aprovuar	Aktual
KEK	4,021	4,227
Import	152	192
BRE	359	296
Total	4,531	4,714

Blerjet në mil'€	Aprovuar	Aktual
KEK	118.63	124.69
Import	12.33	25.83
BRE	12.15	9.47
Total	143.10	159.99

Meqenëse të hyrat e furnizuesit mbulojnë të gjitha kostot e sistemit elektroenergjetik, kostot dhe të hyra e tij janë të ndikuara edhe nga kostot e bartshme. Përfundimisht, siç mund të shihet në tabelën në vijim kostot e realizuara të furnizuesit janë rritur për 13% nga ato të aprovuara dhe krahasuar me të hyrat e faturuara faktori korrigjues ka arritur në 24.4 milion € apo 8% ndaj MAR-it të lejuar, siç shihet në tabelën e mëposhtme:

MAR 2021	Aprovuar 2021	Aktuale 2021
Shpenzimet Operative	6.26	6.47
Blerjet me shumicë	147.22	165.88
Kostot për OST	17.81	20.96
Kostot për OSSH	90.51	104.90
BRE fondi	9.91	10.45
Kostot tjera	18.43	19.97
FINAL MAR	290.14	328.63
Të hyrat aktuale	295.21	306.15
KREV 2021	5.07	24.37
<i>Ndikimi</i>		8%

Sidoqoftë, ndikimi financiar dhe kostot që mbart FSHU-ja nuk përfundojnë në dhjetor, por të njëjtat vazhdojnë të mbeten barrë e FSHU-së deri në mars të vitit 2022, kur pritet të bëhet rishikimi i kostove gjatë përcaktimit të vitit të ardhshëm tarifor.

Parashikimet e FSHU-së për blerjet me shumicë sipas draft bilancit për vitin 2022, vetëm për tremujorin e parë të vitit 2022 janë 58.3 milion €, me një çmim mesatar të importit të parashikuar prej 484 €/MWh, sipas parashikimeve të tregut hungarez për tremujorin e parë të vitit 2022. Nëse marrim parasysh edhe kostot tjera të pritshme për tre muajt e parë të vitit 2022, kostot e parashikuara të FSHU-së arrijnë vlerën prej 126.7 milion €. Respektivisht, marrë parasysh edhe ndikimin e KREV për vitin 2021, kostot totale të FSHU-së për periudhën janar-mars arrijnë vlerën prej 152.1 milion €, me një përqindje të pambulueshmërisë prej 37%, siç është paraqitur në tabelën vijuese:

MAR Jan-Mars 2022	Mil €
Shpenzimet Operative	2.04
Blerjet me shumicë	60.04
Kostot për OST	7.59
Kostot për OSSH	47.28
BRE fondi	4.68
Kostot tjera	30.46
FINAL MAR	152.09
Të hyrat aktuale	95.39
<i>Pambulueshmëria</i>	<i>56.70</i>
<i>Pambulueshmëria në %</i>	<i>37.28%</i>

Për sqarim, marrë parasysh se Rregullatori është në proces të shqyrtimit të vlerave hyrëse dhe për të cilat ende nuk është marrë vendim, FSHU në vlerësimet e tij ka përdorur shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes sipas realizimeve aktuale të vitit 2021 të përshtatura për normë të inflacionit, ndërsa vlerat hyrëse kanë mbetur të njëjta me vitet paraprake.

Për më tepër, me qëllim të vlerësimit të saktë të kostove të sistemit, FSHU –ja në vlerësimet e tij për kostot e bartshme ka vlerësuar një rritje prej 52.04% të tarifave të OSSH-së dhe OST-së. Kjo rritje është bazuar në nevojën e rritjes së FSHU-së pa përfshirë kostot e bartshme. Në mungesë të informatave për të licencuarit e tjerë, FSHU ka përdorur të njëjtin supozim në vlerësimet e tyre. Çdo ndryshim nga ZRRE-ja përgjatë caktimit të tarifave për OSSH-në dhe OST-në duhet të pasqyrohet në MAR-in përfundimtar për Furnizuesin me Shërbim Universal.

Marrë parasysh të lartë thënat, sipas të drejtës së dhënë përmes legjislacionit në fuqi dhe duke marrë parasysh kushtet e jashtëzakonshme të krijuara në mbarë botën lidhur me rritjen e madhe të çmimeve të energjisë elektrike dhe me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar, FSHU-ja kërkon nga ZRRE që të aprovoj kërkesat e drejta dhe të arsyeshme brenda periudhës së përcaktuar si më lartë. Në të kundërtën, shpërndarja e kostove në afate më të gjata nuk paraqet zgjidhje konkrete dhe e njëjta duhet të merr për bazë të gjitha kostot e pritshme për vitin 2022.

3. Kërkesa për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2022

Në përputhje me kërkesat ligjore dhe afatet kohore të përcaktuara në Rregullën për Bilancin e Energjisë, Furnizuesi me Shërbim Universal ka parashikuar konsumin për vitin 2022, të cilat janë ndarë me KOSTT si palë përgjegjëse për hartimin e Bilancit të Energjisë. Parashikimi i dorëzuar më parë është përgatitur duke marr për bazë realizimin aktual deri në kohën kur është përgatitur dokumenti, kurse pjesa tjetër është parashikuar. Mirëpo, krahasuar me të dhënat e matura për pesë muajt e fundit të vitit 2021 me vlerat e matura për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar vërehet një rritje prej 12,64%. Si rezultat, FSHU-ja në parashikimin e të hyrave të lejuara për vitin 2022 ka konsideruar vlerat me realiste të pritshme të konsumit.

Sipas konsumit të pritshëm si më lartë, FSHU-ja ka parashikuar blerjet e nevojshme për vitin 2022, duke mbuluar fillimisht nevojën nga prodhimi vendor, konform draft bilancit për vitin 2022, ndërsa mungesat e prodhimit vendor parashihen të mbulojnë nga importi.

Kriza globale e energjisë elektrike e përhapur gjatë vitit 2021, pritet të vazhdojë edhe përgjatë vitit 2022 sipas parashikimeve të çmimeve të importit në tregjet ndërkombëtare, të cilat janë pasqyruar në tabelën vijuese:

€/MWh	Çmimi jashtë pikut	Çmimi i pikut
Q1 2022	384.19	492.20
Q2 2022	253.49	305.46
Q3 2022	251.82	308.84
Q4 2022	270.50	338.64

Sipas të lartë thënëave, kostot e blerjeve me shumicë për nevojat e FSHU-së për vitin 2022 janë 235 milion € për 5,081 GWh të pritshme.

Blerjet	MWh	€mil
KEK	4,103	121
Import	316	87
BRE	662	27
Total	5,081	235

Rregullatori në tetor të vitit 2021 ka ri-hapur procesin shqyrtimit të vlerave hyrëse, të cilat janë në proces të shqyrtimit. Pa paragjykuar vendimet përfundimtare, FSHU në vlerësimet e tij ka përdorur shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes sipas realizimeve aktuale të vitit 2021 të përshtatur për normë të inflacionit, ndërsa vlerat hyrëse kanë mbetur të njëjta me vitet paraprake.

Për më tepër, me qëllim të vlerësimit të saktë të kostove të sistemit, FSHU-ja në vlerësimet e tij për kostot e bartshme ka vlerësuar një rritje prej 41.38% të tarifave të OSSH-së dhe OST-së, e cila është e bazuar në nevojën e rritjes së FSHU-së për vitin 2022 pa përfshirë kostot e bartshme. Në mungesë të informatave për të licencuarit e tjerë, FSHU ka përdorur të njëjtin supozim në vlerësimet e tyre. Çdo ndryshim nga

ZRRE-ja përgjatë caktimit të tarifave për OSSH-në dhe OST-në duhet të pasqyrohet në MAR-in përfundimtar për Furnizuesin me Shërbim Universal.

Në përputhje me argumentet e prezantuara me lartë, kostot e pritshme të Furnizuesit me Shërbim Universal për vitin 2022 janë 479.45 milion €.

MAR 2022	Milion €
Shpenzimet Operative	7.87
Blerjet me shumicë	242.22
Kostot për OST	26.24
Kostot për OSSH	145.05
BRE fondi	14.45
Kostot tjera	43.61
FINAL MAR	479.45
Të hyrat aktuale	329.80
<i>Pambulueshmëria</i>	<i>149.65</i>
<i>Pambulueshmëria në %</i>	<i>31.21%</i>

Të hyrat e pritshme me tarifat aktuale janë 329.8 milion €, respektivisht kemi një pambulueshmëri prej 149.65 milion € apo 31.21% të kostove të pritshme.

Është e rëndësishme të theksohet se me qëllim të krijimit të stabilitetit financiar për FSHU-në, ZRRE gjatë shqyrtimit tarifor duhet të marr për bazë vlerën kohore të parasë, prandaj është shumë e rëndësishme që të reflektohen me kohë rritjet e pritshme. Vonesat e mundshme në reflektimin e drejtë të tarifës së pritshme do të vazhdoj të rëndoje tutje stabilitetin financiar të FSHU-së, përkatësisht mund të lind nevoja për shqyrtim të jashtëzakonshëm përsëri.